



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pimljen / Profato Received / Delivery	20.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHUK	7587/2023		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1317/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave** në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1317/2023 të datës 24.10.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë banimi: \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore-vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.12.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1317/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Anulohet** masa disiplinore "Vërejtje", e shqiptuar me datë 29.09.2023 nga Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- III. Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, duke e hequr masën disiplinore "Vërejtje" nga dosja e ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 24.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.prot.6660/2023 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 29.09.2023 të shqiptuar përmes e-mailit zyrtar nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë/Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike A.K, bazuar në kërkesën /shkresën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) Z.D.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore-vërejtje janë shkelur dispozitat e ligjit material dhe trajtim jo i barabartë sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me arsyetimin se është konstatuar gabimisht gjendja faktike pasi që sipas procesverbalit të takimit të datës 29.09.2023 përcaktohet qartë se nuk ka deklaram nga asnjë pjesëmarrës apo akt që unë të ke ushtruar presion ndaj znj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 26.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë, Tregtisë. Ndërsa Këshilli më datë 01.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6660/2023 të parashtruar nga ankuesi më date 24.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbalin e takimit me sektorin e zonave ekonomike-Departamenti për Zhvillimin e sektorit Privat i datës 25.09.2023; E-mailin e datës 29.09.2023 dërguar nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 29.09.2023; E-mailin e datës 28.09.2023 dërguar nga [redacted] për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 03.08.2023 dërguar nga ankuesi për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 24.10.2023 dërguar nga ankuesi për këshillin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.10.2023; Përgjigje në kërkesë të datës 01.11.2023; Akt emërimit e ankuesit të datës 19.09.2019 dhe përshkrimin e detyrave të punës; vendimin e datës 23.03.2023; Vendimin e datës 04.07.2023; Vendimin e datës 13.07.2023; Kontratën e datës 23.06.2023; Vendimin e datës 29.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka komnstatuar se ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 11.07.2019, është i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në pozitën e punës "Zyrtar për Zhvillim të Zonave Ekonomike" në kuadër të Devizionit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike, kurse me datë 27.09.2023 U.d i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA-s [redacted], përmes emailit zyrtar drejtuar Drejtorit të Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë [redacted] ka kerkuar nga drejtori i lartepemendur që nëë cilesine e mbikqyresit të inicoj procedurën për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" për ankuesin me arsyetimin se i njëjti, ka ushtruar presion të vazhdueshëm tek znj. [redacted] anëtare e Komisionit për pranim teknik të kontratës "Ndërtimi i Infranstrukturës për Parkun Industrial në Brudrikë - Viti" në lidhje me vlerësimet që duhet bërë në Komisionin për pranim teknik të "Parkut Industrial në Budrikë".

Më pastaj me datë 28.09.2023 Drejtori i Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar Udhëheqësit të Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, duke iu referuar e-mailit të datës 27.09.2023 të U.D i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA-s, ka kërkuar që ta trajtohet me kujdesë ky proces dhe te veprohet konform kompetences dhe hierarkisë ndaj nepunesve M.J dhe anuesit, ndërsa me datë 29.09.2023 përmes e-mailit zyrtar Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Vërejtje" duke e vendosur të njëjtën edhe në dosjen personale të tij.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e rënda të detyrave të punës: "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar" dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mund t'i shqiptohet ndonjëra nga masat e përcaktuara disiplinore të cekura me ligjin material, mirëpo vetëm në rastet kur përmbushet parakushti ligjor apo kur konsumohen elementet e përgjegjësive disiplinore, mirëpo në secilin rast të shqiptimit të masës fillimisht duhet të konstatohet fakti apo të kualifikohet shkelja disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe dëshmive të ofruara në lëndë, konstaton se Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit, duke e vendosur të njëjtën në dosjen personale të saj nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësive disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", sepse në rastin konkret në bazë të dëshmive të ofruara, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të datës 29.09.2023 përmes e-mailit ndaj ankueses përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike, i njëjti nuk ka arritur të vërtetoj as gjendjen juridike sepse në masën e shqiptuar disiplinore përmes emailit nuk i është referuar asnjë dispozite të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesja gjegjësisht nuk ka konstatuar që me veprimet apo mos veprimet e saj gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët



Publikë, gjegjësisht i ka shqiptuar masën disiplinore pa e cilësuar veprimet e saj se a përbejnë shkelje të lehta apo shkelje të rënda, rrjedhimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses nuk ka vlerësuar drejtë natyrën e shkeljes së supozuar nga ana e ankueses, andaj mbi këtë bazë inicimi i kësaj procedure ndaj ankuesit është bërë në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*.

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar që masa disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i tij, përveç që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publike është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse masa disiplinore-vërejtja e shqiptuar ndaj ankueses nuk përmbanë elementet e një akti administrativ, ashtu sië është përcaktuar me nenin 47 të këtij ligji ku theksohet qartë se : 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë'', pasi që masa e shqiptuar përmes e-mailit të datës 29.09.2023 nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh shkeljet ligjore dhe procedurale në këtë procedurë disiplinore nuk është lëshuar në shkelje materiale, gjegjësisht nuk është lëshuar në atë nëse ankuesi ka bërë shkelje disiplinore, andaj si rezultat i kësaj, për shkak të këtyre rrethanave, Kolegji konstaton që masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 99 pika 6 të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, respektivisht "vërejtja" është e paligjshme edhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe Udhëheqësi i Njësisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, janë të obliguar që bëjnë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij sipas këtij Vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1317/2023.

**Elakron GASHI**

Zyrtare e lartë për bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Sektorit të Zonave Ekonomike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.